

QENDRA E RESURSEVE
e prindërve të fëmijëve
me aftësi të kufizuara



Në çfarë mënyre të sillemi
ndaj personave me
**DËGJIM TË
DËMTUAR**

BËJENI HAPIN E PARË



Pasojat nga dëmtimi i të dëgjuarit nuk ndër- lidhen vetëm me personin me dëgjim të dëmtuar. Ato, gjithashtu kanë ndikim të madh edhe mbi familjen, miqtë dhe kole- gët në punë.

Komunikimi i vështirësuar, mungesa e kup- timit, nevoja e përsëritjes të asaj që është thënë mund të jenë frustruese për secilin që është kyçur në komunikim. Për fat të mirë, ka disa mënyra me të cilat mund të leh- tësoni komunikimin.



Hapi i parë, kuptohet, është të parashtroni pyetjen: Cilat janë problemet që i shqetësojnë personat me dëgjim të dëmtuar?

FAKTE LIDHUR ME DËMTIMIN E TË DËGJUARIT

1. Pjesa më e madhe e personave me dëgjim të dëmtuar përballohen me fuqi të dobësuar të zërit dhe me qartësi të dëmtuar të të folurit, madje edhe kur është mjaft i zëshëm. Ndonëse personi mund të "dëgjojë" se çfarë flitni, jo çdoherë i kupton të gjitha fjalët që i thoni ose mund t'i përziejë disa prej zërave.



2. Zhurma në prapavijë dukshëm e vështirëson kuptimin. Madje edhe personat me dëgjim normal kanë problem me komunikimin kur në prapavijë ka zhurmë të fuqishme. Tek personat me dëgjim të dëmtuar ky problem është madje më i madh.
3. Shumë persona me dëgjim të dëmtuar nuk ndjehen këndshëm, dhe prandaj shpesh



vetëm lëvizin me kokë dhe shtirren sikur kuptojnë edhe në raste kur nuk kuptojnë se çfarë ju flasim.

4. Ndonëse aparatet për dëgjim mund të ndihmojnë me të dëgjuarit, ata nuk e kthejnë kuptimin në normale, siç është rasti me syzet që e përmirësojnë shikimin. Personi që mban aparat të dëgjimit, në disa raste, edhe më tutje ka vështirësi me kuptimin e të folurit.



5. Duhet një kohë e caktuar që personi me dëgjim të dëmtuar të mësohet me aparatën për dëgjim, megjithatë ajo është mjaft e vështirë për ata që gjatë kohë kanë qenë me dëgjim të dëmtuar. Zërat që i kanë harruar duhet sërish t'i mësojnë. Bota ju duket tepër e zhurmshme, në fillim, madje edhe shurd-

hohen nga zhurma. Nëse njihni dikë që ka përdorur aparat dëgjimi dhe ka ndërprerë me përdorimin e aparatit, inkurajoni që sërish të shkojë në mjek specialist, i cili sërish do të përshtat aparatin për dëgjim. Ndoshta do të duhet disa herë të vizitohet specialisti që të mund me rehati të arrihet zëri cilësor. Durimi dhe inkurajimi juaj mund të jetë një ndihmë e madhe.

6. Dëmtimi i dëgjimit tek personat e mos-huar mund lehtë të përzihet me senilitetin andaj edhe duhet që dëgjimi të testohet, dhe ky testim të jetë pjesë e çdo vlerësimi shëndetësor.

SHPREHI TË MIRA TË KOMUNIKIMIT



1. **Tërhiqeni vëmendjen e personit me dëgjim të dëmtuar para se të filloni të bisedoni.**

Nëse ia keni tërhequr vëmendjen personit, atëherë personi do të jetë gati për komunikim dhe do të ketë më pak gjasa që të ikë diçka nga komunikimi.

2. Mos bërtitni!

Flitni qartë, por jo me tepër zë. Të folurit të jetë i qartë, por mos theksoni tepër fjalët tuaja.



3. Mos flitni tepër shpejtë, ose tepër ngadalë.

Personat me dëgjim të dëmtuar shumë mirë kuptojnë bashkëfolësit nëse të folurit është pak më i ngadaltë, por jo tepër i ngadaltë!



4. Fytyra juaj të jetë në vend të dukshëm.

Ndriçimi duhet të jetë më i përshtatshëm që mos të mbuloj me hije fytyrën tuaj ose gojën. Shumë zëra të të folurit mund të vërehen nga goja, andaj personi me dëgjim të dëmtuar mund të përdor atë si mbështetje.

5. Mos flitni kur rrjedh ujë diku!

Zhurma në prapavijë dukshëm e vësh-tirëson kuptimin. Ndaloni burimin e zhur-mës para se të filloni bisedën me perso-nin me dëgjim të dëmtuar ose, nëse keni mundësi, kaloni në një vend më të qetë.



6. Mos flitni me persona në hapësirë tjetër.

Largësia nga personat që dëgjojnë është shumë e rëndësishme. Sa më larg të jeni, aq më të vogla janë gjasat që t'ju dëgjojnë. Mundohuni të jeni në hapësirën e njëjtë dhe mjaft afër që të mund më lehtë t'ju dëgjojnë dhe shikojnë.





7. Më mirë riformulo sesa të përsëritësh.

Nëse kërkojnë nga ju të përsëritni, shumë do të ndihmoni nëse e riformuloni atë që keni thënë. Ndonjëherë përdorimi i fjalëve tjera mund më lehtë të kuptohet.

8. Jini të gatshëm që mos t'ju kuptojnë.

Parashtroni pyetje kohë pas kohe që të siguroni që personi ju ka kuptuar.

9. Rehatohuni dhe keni durim.

Personat me dëgjim të dëmtuar shpesh janë nën shumë stres, sepse përqendrohen në kuptimin e secilës fjale që shqiptohet. Imazhi i këndshëm i fytyrës dhe qëndrimi perceptues mund të ndihmojë personin me dëgjim të dëmtuar që të rehatohet dhe të kënaqet në bisedën.

Të dëgjuarit dhe të kuptuarit janë nevojat themelore të njeriut. Problemet me dëgjimin, si dhe sfidat sociale që rrjedhin nga këto probleme, paraqesin një fushë të zhvillimit të vazhdueshëm dhe largim të paragjykimeve në secilën shoqëri bashkëkohore. Ne besojnë në një botë që falë teknologjisë së avancuar, personat me dëgjim të dëmtuar do të mund të komunikojnë pa asnjë kufizim

GJUHA ME SHENJA



Një veçori themelore specifike e personave të shurdhër dhe gjysmë të shurdhër është përdorimi i GJUHËS SË SHENJAVE si mjet i komunikimit me personat e tjerë. Ky është një sistem i kushtëzuar i lëvizjeve të akorduara të duarve, të shoqëruar me mimikë dhe të folurit e trupit që kanë një domethënie të caktuar.

Duart janë mjeti themelor që përdoret gjatë komunikimit me gjuhën e shenjave. Shenjat prezantohen me lëvizje të caktuara dhe vendosje të caktuar të dorës ose të dy duarve. Domethënia e shenjës është përcaktuar në ato elemente themelore në të cilët duhet të ketë vëmendje:

- **vendosja e dorës – vendosja e gishtave të dorës ose dy duarve;**
- **lëvizja e dorës ose dy duarve;**
- **pozita – vendndodhja e shenjës në hapësirën e shenjave;**
- **orientimi i pëllëmbës së dorës.**

Ka edhe elemente plotësuese që mundësojnë komunikimin e gjuhës me shenja, me qëllim të ketë kuptim më efikas si për folësin ashtu edhe për bashkëfolësin. Gjatë të folurit me gjuhën e shenjave përdoren dhe lëvizin edhe pjesët e tjera të trupit që shenjat të mund të marrin një prezantim më të qartë të domethënies së termit që prezantojnë. Këto pjesë në të cilat nuk përdoren duart janë: lëvizja e kokës; shprehja e fytyrës; lëvizja e gojës; lëvizja e trupit.

GJUHA E SHENJAVE NUK ËSHTË UNIVERSALE

Komunikimi ndërkombëtar i shenjave është një mënyrë e kuptimit të ndërsjellë të personave të shurdhër që përdorin gjuhë të ndryshme të shenjave. Baza e këtij komunikimi është gjuha amerikane e shenjave (ASL), që përdoret në mbledhjet zyrtare ndërkombëtare.

Në Konventën e OKB-së të nënshkruar më 30 mars 2007 dhe ratifikuar nga RM-ja më 29 dhjetor 2011, ka 7 nene në të cilat theksohet barazimi i gjuhës së shenjave me atë të folurit.

<http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf>

GJUHA MAQEDONASE E SHENJAVE

Gjuha maqedonase e shenjave dhe përdorimi në Maqedoni janë të rregulluar me Ligjin për Përdorimin e Gjuhës së Shenjave që prej gushtit të vitit 2009. Me këtë rregullohet përdorimi

i gjuhës së shenjave, të drejtat e personave të shurdhër për gjuhën e shenjave, mësimi i gjuhës së shenjave, interpretimi i gjuhës së shenjave, dhe tjera.

Me këtë ligj, në Maqedoni, secili institucion shtetëror dhe shoqëror ka për detyrë të sigurojë interpretues të gjuhës së shenjave nëse ndonjë person i caktuar ka nevojë për atë.

Trajnimi për mësimin e gjuhës së shenjave në Maqedoni bëhet në Lidhjen e Personave të Shurdhër dhe Gjysmë të Shurdhër të Maqedonisë <http://www.deafmkd.org.mk> dhe Institutit të Defektologjisë në Shkup. Interpretuesit që kanë kaluar trajnimin përfitojnë një certifikatë për interpretues të autorizuar në territorin e Maqedonisë.

8 KEQKUPTIME MË TË SHPESHTA PËR PERSONAT ME DËGJIM TË DËMTUAR

Keqkuptimi nr. 1

Fëmijët me dëgjim të dëmtuar shpesh lindin në familje ku prindërit kanë dëgjim të dëmtuar.

Madje edhe 90% të fëmijëve të lindur me dëgjim të dëmtuar rrjedhin nga familjen që NUK kanë dëgjim të dëmtuar. Mesatarja botërore është 2-3 fëmijë me dëgjim të dëmtuar në 1000 fëmijë të lindur.

Keqkuptimi nr. 2

Gjuha e shenjave është mënyra themelore dhe e vetme e komunikimit mes fëmijëve me dëgjim të dëmtuar.

Sot, mund lirisht të themi që pjesa më e madhe e fëmijëve me dëgjim të dëmtuar përdorin komunikim verbal që është mundësuar me avancimin teknologjik në trajtimin e formave më të vështira të dëmtimit të dëgjimit.

Keqkuptimi nr. 4

Fëmijët me dëgjim të dëmtuar janë inferior në kuptimin intelektual dhe nuk mund të kenë talent.

Nëse kushdo jep udhëzime në gjuhë që nuk e kuptojmë dhe prej nesh pritet të plotësojmë kërkesën, sigurisht që do të vlerësohet që nuk jemi shumë të mençur të përgjigjemi në mënyrën që pritet dhe nuk kemi arritur të përfundojmë detyrën e kërkuar.



Ky do të jetë vlerësim i secilit që nuk ka kuptim të mjaftueshëm për gjendjen e personave me dëgjim të dëmtuar.

Dëgjimi i dëmtuar nuk ndikon mbi talentin, potencialet dhe kapacitetet e personit me dëgjim të dëmtuar!



Keqkuptimi nr. 5

Aparatet e dëgjimit dhe implantet kthejnë të dëgjuarit në normale.

Në çfarë mase fëmija me dëgjim të dëmtuar do të zhvillojë të folurit dhe kuptimin varret nga shumë faktorë: lloji dhe përmasa e dëmtimit, kohëzgjatja e rehabilitimit, aparati për dëgjim, etj.

Shkenca dhe teknologjia në këtë fushë janë mjaft të avancuar, por sërish ka shumë për të arritur barazimin e teknologjisë natyrore të dëgjimit.

Keqkuptimi nr. 6

Të folurit me zë dhe tepër të ngadaltë mund të ndihmojë për kuptim më të mirë.

Ky lloji i të folurit mund vetëm të kontribuojë për shtrembërimin e të folurit dhe mimikës së fytyrës, duke e bërë kuptimin e të folurit më të vështirë. Më mirë është që fjalitë të shkurtohen dhe të jenë konkrete pa shkurtimin e fjalëve dhe/ose zërave.



Keqkuptimi nr. 7

Fëmijët me dëgjim të dëmtuar janë të pa-rehatshëm dhe ndërhyrës.

Ju ndodh që fëmijëve me dëgjim të dëmtuar, ndonëse kanë vullnetin më të mirë, të reagojnë në mënyrë të papritur dhe në shikim të parë në mënyrë të pahijshme. Por, kjo shpesh është një reagim i kuptimit të pamjaftueshëm i fjalëve dhe/ose nevoja e tyre nga shoqërimi që mund të shkaktojë ndërhyrje në fjalë, mos respektim të hierarkisë dhe mos respektim të normave të përgjithshme të sjelljes. Këto rrethina mund t'i kuptojë si ndërhyrje.

Nuk duhet me shembullin e sjelljes t'i kushtojmë vëmendje rrethinës për aspektin specifik të situatës.

Keqkuptimi nr. 8

Në rregull është të thoni “nuk ka rëndësi” kur fëmija mundohet të kuptojë atë që flitni, ndërsa ju nuk arrini ta sqaroni.



Assesi nuk është në rregull! Për fëmijët me dëgjim të dëmtuar është mjaft shqetësuese nëse nuk mund të ndjekin bisedën në shoqërinë në të cilin gjenden dhe kanë nevojë për inkurajim që vazhdimisht të kërkojnë të përsëritet diçka. Përgjigja, Nuk ka rëndësi, i zhgënjen dhe i bënë më tepër të shqetësuar.

Ju duhet të mendoni dhe të mundoheni me sqarime plotësuese, gjeste ose vizatime të sqaroni se çfarë dëshironi të thoni ose pyetni.

Të dëgjuarit dhe të kuptuarit janë nevojat themelore të njeriut. Problemet me dëgjimin si dhe pasojat sociale që rrjedhin nga gjendja paraqesin sfidë për shoqërinë dhe për të gjithë ne.

<http://sajberuvce.org/>

Shurdhia dhe gjysmë shurdhia nuk përcakton personin, ajo do të thotë vetëm një nevojë e sistemeve dhe ndihmesave plotësuese për mbështetje në funksionim.



QENDRA E RESURSEVE
e prindërve të fëmijëve
me aftësi të kufizuara

QENDRA E RESURSEVE

rr. Vasko Karangeleski 33

1000 Shkup

++389 78 449 851

++389 78 449 852

www.resursencentar.mk

Hartimi i broshurës është mundësuar me mbështetjen financiare e UNICEF-it, në kuadër të projektit: "Rritja e Mundësive për Inkluzion dhe Përmirësimi i Cilësisë së Jetës së Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara me anë të Fuqizimit të Prindërve dhe Familjeve të Tyre".



Qëndrimet e shprehura në këtë broshurë janë vetëm të autorëve dhe nuk duhet patjetër të përputhen me qëndrimet dhe politikat e UNICEF-it.